



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr./ Br. / No.	2036	Nr. i faq./ Br. str / N. p. pg 1
Data / Datum / Date	14.08.2024	Pejë / Poç

Këshilli Drejtues

Datë: 14.08.2024

Në bazë të nenit 17 dhe nenit 23 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur me 13.08.2024, ka shqyrtuar kërkesën nr. Ref. 2021, dt. 12.08.2024, dhe morri këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohet** kërkesa nr. Ref. 2021, dt. 12.08.2024 për Procedurat e tenderit me titull "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të brendshme në Objektet e UHZ-së".
- II. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Drejtues i UHZ-së, me datë 13.08.2024, shqyrtoj kërkesën nr. Ref. 2021 dt. 12.08.2024, lidhur me Procedurat e tenderit të Pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave të brendshme në Objektet e UHZ-së, Nr. i prokurimit UHZ-24-547-2-1-1, duke pas parasysh që UHZ ka mbet pa shërbime të pastrimit që një muaj. Universiteti "Haxhi Zeka" me datë 04.06.2024 ka hapur njoftim për kontratë për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave të brendshme në Objektet e UHZ-së", të gjitha procedurat janë shqyrtuar brenda afateve kohore sipas ligjit të prokurimit, mirëpo, pas përzgjedhjes së operatorit ekonomik gjatë fazës të së drejtës së ankimimit janë parashtruar ankesa në Organin Shqyrtues të Prokurimit - OSHP nga operatorët tjerë ekonomik. Andaj, duke u bazuar në ligjin e prokurimit, KD aprovon kërkesën për zhvillimin e procedurave në përputhje me nenin 35 "Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës", deri në lidhjen e kontratës kornizë me titull "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të brendshme në Objektet e UHZ-së". Kjo kontratë (marrëveshje) është valide derisa të vendoset lidhur me ankesat e operatorëve ekonomik nga ana e OSHP-së.

Këshilli drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Kryesuese e Këshillit Drejtues të UHZ-së
Prof. Ass. Dr. Emine Abdyl

Emine Abdyl



Vendimi t'i dërgohet:

Kryesueses së KD-së,
U.d. Sekretares së Përgjithshme,
Prorektorit për Infrastrukturë, Buxhet dhe Financa,
Kryesuesit të IT-së dhe
Arkivës së UHZ-së.